



“Qendra Sportive Kuq e Zi” sh.a.
Keshilli i Administrimit



Tirane, 24/06/2011

V E N D I M

Nr. 2 Dt.24/06/2011

Emerimi i Z. Ardian Cani ne pozicionin e Administratorit te shoqerise, miratimi i afatit te emerimit dhe pages mujore

Keshilli i Administrimit te shoqerise ne mbledhjen e tij date 24.06.2011,

V E N D O S I :

- 1- Emerimin e Z. Ardian Cani ne pozicionin e Administratorit te shoqerise, me nje afat 3 (tre) vjecar.
- 2- Te miratoj pagen mujore te Administratorit ne vleren 120,000 neto ne muaj.
- 3- Ky vendim hyn ne fuqi me date 26.06.2011.

Kryetari

Armand Duka



Anetaret e Keshillit te Administrimit:

1. Eduard Prodani

2. Skender Hyka

3. Besnik Cela

4. Endri Jorgoni

QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI sh.a.
KESHILLI I ADMINISTRIMIT

V E N D I M

Nr 13, dt. 25/03/2014

Per emerimin e Administratorit te Shoqerise

Keshilli i Administrimit te Shoqerise, ne zbatim te nenit 22 te Statutit te Shoqerise

V E N D O S I:


1. Lirimin e zotit Ardian Ramazan Cani nga detyra e Administratorit te Shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi"
2. Emerimin e zotit Eduard Prodani, i biri i Luanit, i datelindjes 18.06.1963, ne detyren e Administratorit te Shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., i cili do te qendroje ne kete detyre per nje afat 3 (tre) vjecar nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi.
3. Depozitimin e ketij vendimi ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit per pasqyrimin e ndryshimeve
4. Ky vendim hyn ne fuqi ne daten 25.06.2014

Per Keshillin e Administrimit

Armand Duka
Kryetar



Skender Hyka
Anetar



Eduard Prodani
Anetar



Vladimir Gjonaj
Anetar



Besnik Çela
Anetar



Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a

Tiranë, Rruga "Elbasanit"
NUIIS: L 11705012 O

VENDIMI
I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT
datë 30.10.2017

Në Tiranë, sot më datë 30.10.2017 Këshilli i Administrimit të shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., në selinë e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë

VENDOSI:


1. Shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., duke u larguar z.Eduard Prodani nga detyra e administratorit të shoqërisë dhe emërimin Administrator të shoqërisë z. **Ramadan Shehi**, i biri i Jonuz, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 14.07.1948, lindur në Kukës e banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. E80714057T, i cili do të qëndrojë në detyrë për një afat 3 (tre) vjeçar.
2. Autorizimin e znj.Daniela Mujka, që të ndjekë procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

z.Ramadan SHEHI



z.Skënder HYKA



z.Gjergj KOSTA



z.Illir SHULKU.



z.Armand DUKA



Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a

Tiranë, Rruga "Elbasanit",
NUIS: L 11705012 O

VENDIM I

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQËRISË

datë 30.10.2017

Në Tiranë, sot më datë 30.102017 Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., në selinë e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë

VENDOSI:

1. Shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit z.Besnik Çela dhe z.Eduart Prodani;
2. Emërimin e për një afat 3 (tre) vjeçar të anëtarëve të këshillit të administrimit si vijon:
 - a. z.Ramadan Shehi
 - b. z.Skender Hyka
 - c. z.Armand Duka
 - d. z.Illir Shulku
3. Miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2013, 2015, 2016;
4. Refuzimin e faturës tatimore të eksperteve Sanije Stafa dhe Vullnetare Cela
5. Autorizimin e znj. Daniela Mujka, që të ndjekë procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.**

Përfaqësuar nga

(në mungesë)

z. Armand DUKA





“Qendra Sportive Kuq e Zi” sh.a.

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

V E N D I M

Nr. 1 Dt.24/04/2012

Emërimi i anëtarit të ri te Këshillit të Administrimit të Shoqërisë

Asambleja e shoqërisë ne mbledhjen e saj datë 24.04.2012, ne zbatim te nenit 21, pika 2 e Statutit te shoqërisë:

V E N D O S I :

- 1- Shkarkimin e Z. Endri Jorgoni nga pozicioni i Anëtarit të Këshillit të Administrimit te shoqërisë.
- 2- Emërimin e Z. Edlir Vokopola në pozicionin e anëtarit të ri të Këshillit të Administrimit të shoqërisë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi me datë 24.04.2012.

Anëtarët e Asamblesë:

Z. Armand Duka

President FSHF



Ado Bumçi

Minister MTKRS





ASAMBLEJA E ZAKONSHME

V E N D I M

Nr. 1 Dt 20/01/2014

Emërimi i anëtarit të ri te Këshillit të Administrimit të Shoqërisë

Asambleja e shoqërisë ne mbledhjen e saj datë 20.01.2014, ne zbatim te nenit 21, pika 2 e Statutit te shoqërisë:


V E N D O S I :

- 1- Shkarkimin e Z. Edlir Vokopola nga pozicioni i Anëtarit të Këshillit të Administrimit te shoqërisë.
- 2- Emërimin e Z. Vladimir Gjonaj në pozicionin e anëtarit të ri të Këshillit të Administrimit të shoqërisë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi me date 20.01.2014.

Anëtarët e Asamblesë:

Z. Armand Duka

Znj. Lindita Nikolla


President FSHF




Minister MAS



SHOQËRIA TREGTARE
QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI
NIPT L117050120

VENDIM

I

ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Sot më datë 11/01/2016, ora 10.00, pranë selisë së shoqërisë në adresën Rruga e Elbasanit, brenda ambienteve të Federatës Shqiptare të Futbollit, u mbajt mbledhja e përgjithshme e aksionarëve e thërritur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon :

- Zëvendësimi i njërit prej aksionerëve të Shoqërisë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015 (bashkëngjitur këtij Vendimi);
- Ndryshimin e objektit të veprimtarisë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015
- Zëvendësimi i anëtarit aktual të Këshillit të Administrimit Zotit Vladimir Gjoni me anëtarin e ri Zotin Gjergji Kosta, sipas shkresës të Ministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nr. 194/2, datë 11.01.2016
- Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm të dy aksionarët e shoqërisë, të cilët përfaqësojnë masën prej 100% të kapitalit aksioner, si vijon:

- Federata Shqiptare e Futbollit e përfaqësuar nga ana e Presidentit të saj Z. Armand DUKA;
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përfaqësuar nga ana e Z. Gjergji Kosta, sipas autorizimit nr. 194, datë 11.01.2016.

Duke qenë se vërtetohet kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e kësaj mbledhjeje, procedohet me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Administratori i shoqërisë Qendra Sportive Kuq e Zi parashtroi përpara aksionarëve se në bazë e për zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015 kërkohet zëvendësimi i njërit prej aksionarëve të shoqërisë Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me aksionarin e ri Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.



1. Përsa i përket pikës së parë të rendit të ditë, aksionarët me unanimitet vendosën të miratojnë zëvendësimin e aksionarit ekzistues Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me aksionerin e ri Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Në bazë të këtij ndryshimi si më sipër, aksionerët e shoqërisë Qendra Sportive Kuq e Zi do të jenë:


- Federata Shqiptare e Futbollit, zotëron 1500 aksione në masën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e cila zotëron 500 aksione në masën 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Përsa i përket pikës së dytë të rendit të ditës për ndryshimin e objektit të veprimtarisë të shoqërisë Kuq e Zi, sipas përcaktimeve të bëra në Vendimim e Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015, aksionerët me unanimitet vendosën që në nenin 3 të statutit, objekti i veprimtarisë të shoqërisë të bëhet ndryshimi i më poshtëm :

Projekti dhe ndërtimi i mo bdenizuar i Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa" të ketë një destinacion të dyfishtë.

Pjesa qendrore e projektit dhe ndërtimit të ketë destinacion sportiv, publik, të pandryshueshëm, në përputhje me parametrat e Rregullores së Infrastrukturës së Stadiumeve të UEFA-s, botim i vitit 2010, (UEFA Stadiums Infrastructure Regulations, 2010 Edition). Në projekt dhe në ndërtim të integrohen pjesë me destinacion josportiv, në pronësi të shoqërisë anonime, pa kufizime në disponimin e të drejtave të pronësisë, me qëllim plotësimin e destinacionit të stadiumit të modernizuar."

"1/2. Shoqëria anonime mund të iniciojë procedura përzgjedhjeje, financimi, dhe negociimi për realizimin e projektit të stadiumit, përfshirë edhe pjesën me destinacion josportiv, me subjekte të interesuara, duke bërë pjesë të ofertës, të negociatave dhe transaksioneve me subjektet e interesuara për financimin dhe realizimin e projektit, pjesërisht ose tërësisht, edhe të drejtat ekskluzive të pronësisë për pjesën josportive, të treguar në pikën 1/1."

3. Përsa i përket pikës së tretë të rendit të ditës për ndryshimin e Anëtarit të Këshillit të Administrimit, përfaqësuesit të paketës së aksioneve që zotërohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, aksionerët me unanimitet ranë dakort, që antari aktual Z. Vladimir Gjoni si përfaqësues i ish aksionerit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të zëvendësohet me Zotin Gjergji Kosta, përfaqësues i aksionerit të ri, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sipas shkresës të Ministrit nr. 194/2 datë 01. 01.2016.



Për sa më sipër në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015, në përfundim të mbledhjes dhe duke qenë se nuk ka pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Të zëvendësohet aksioneri i shoqërisë Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me aksionerin e ri Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015 (bashkëngjitur këtij vendimi).
2. Ndryshimin e nenit 3 të statutit të shoqërisë Kuq e Zi, sipas përcaktimeve të bëra në Vendimim e Këshillit të Ministrave Nr. 1092, datë 28.12.2015, si më poshtë :
Projekti dhe ndërtimi i modernizuar i Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa" të ketë një destinacion të dyfishtë.
Pjesa qendrore e projektit dhe ndërtimit të ketë destinacion sportiv, publik, të pandryshueshëm, në përputhje me parametrat e Rregullores së Infrastrukturës së Stadiumeve të UEFA-s, botim i vitit 2010, (UEFA Stadiums Infrastructure Regulations, 2010 Edition). Në projekt dhe në ndërtim të integrohen pjesë me destinacion josportiv, në pronësi të shoqërisë anonime, pa kufizime në disponimin e të drejtave të pronësisë, më qëllim plotësimin e destinacionit të stadiumit të modernizuar."
"1/2. Shoqëria anonime mund të iniciojë procedura përzgjedhjeje, financimi, dhe negocimi për realizimin e projektit të stadiumit, përfshirë edhe pjesën me destinacion josportiv, me subjekte të interesuara, duke bërë pjesë të ofertës, të negociatave dhe transaksioneve me subjektet e interesuara për financimin dhe realizimin e projektit, pjesërisht ose tërësisht, edhe të drejtat ekskluzive të pronësisë për pjesën josportive, të treguar në pikën 1/1."
3. Ndryshimin e antarit aktual të Këshillit të Administrimit Z. Vladimir Gjoni si përfaqësues i ish aksionerit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të zëvendësohet me Zotin Gjergji Kosta, përfaqësues i aksionerit të ri, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sipas shkresës të Ministrit nr. 194/2 datë 01. 01. 2016.



4. Caktohet administratori i shoqërisë ose persona te tjerë të autorizuar prej tij për të përfaqësuar këtë të fundit në procedurat e regjistrimit të sa më sipër.

AKSIONERËT

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Përfaqësuar nga Presidenti Armand Duka

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISE DHE SIPERMARRJES

Përfaqësuar nga Gjergji Kosta

GJERGJI KOSTA



Mbledhja deklarohet e mbyllur në orën 11. 00.

Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a

Tiranë, Rruga "Elbasanit"
NUIB: L 11705012 O

VENDIM I

I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

datë 18.06.2018

Në Tiranë, sot më datë 18.06.2018 Këshilli i Administrimit të shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., në selinë e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë

VENDOSI:

1. Shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., duke u larguar z.Ramadan Shehi nga detyra e administratorit të shoqërisë dhe emërimin Administrator të shoqërisë **z.Bardhyl Minxhozi**, i biri i Tahirit, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 21.10.1956, lindur e banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr.F61021046K , i cili do të qëndrojë në detyrë për një afat 3 (tre) vjeçar.
2. Aprovimin e pasqyrave financiare për vitin 2016.
3. Miratimin e Archea Studio për dizenjimin dhe projektin e arredimit të Stadiumit "Arena Kombëtare".
4. Autorizimin e z. Aldi Topçiu dhe znj.Emi Shena, që të dy së bashku ose veç e veç, të ndjekin procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

z.Ramadan SHEHI

z.Skënder HYKA

z.Stefan Koçollari

z.Illir SHULKU

z.Armand DUKA



Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a

Tiranë, Rruga "Elbasanit",
NUIIS: L 11705012 O

VENDIMI

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQËRISË

datë 12.01.2018

Në Tiranë, sot më datë 12.01.2018 Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., në selinë e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë

VENDOSI:

1. Të kryejë vlerësimin aktual dhe regjistrimi në kontabilitet i truallit prej 2660 m2 bazuar në VKM Nr. 728 datë 08.12.2017 si dhe kalimi në shtesë të kapitalit themeltar të shoqërisë, pa ndryshuar raportet e zotërimit të aksioneve midis Aksionarëve në kapitalin themeltar. Për rrjedhojë, anulimin e vendimit të Asamblesë së Aksionarëve datë 21.04.2017 për pikat 1, 2, 3, 4, 6.
2. Ndryshimin e sistemit të ndriçimit në stadiumin e ri kombëtar nga ai klasik në sistem LED. Financimi i këtij sistemi ndriçimi do të bëhet nga ortaku Federata Shqiptare e Futbollit. Autorizohet administratori i shoqërisë të ndjekë të gjitha praktikat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Shkarkimin e anëtarit të këshillit të administrimit z.Gjergj Kosta;
4. Emërimin e për një afat 3 (tre) vjeçar të anëtarit të këshillit të administrimit z.Stefan Koçollari;
5. Emërimin si auditues ligjor të shoqërisë për certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2017, shoqërinë "Deloitte Audit Albania".
6. Dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Garancisë së Përmbushjes së Marrëveshjes për Projektimin, Prishjen, Financimin dhe Ndërtimin e Kompleksit të Stadiumit të ri Kombëtar, nga Garanci Bankare (Cash Collateral) në garanci përmes një shoqërie Sigurimi.
7. Autorizimin e z. Aldi Topçiu dhe znj.Emi Shena që të dy së bashku ose veç e veç të ndjekin procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Përfaqësuar nga

z. Armand DUKA



Përfaqësuar nga

z.Stefan KOÇOLLARI



Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a

Tiranë, Rruga "Elbasanit",
NUIS: L 11705012 O

VENDIM I

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQËRISË

datë 31.10.2018

Në Tiranë, sot më datë 31.10.2018 Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a., në selinë e shoqërisë, pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë

VENDOSI:

1. Shtimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë si vijon: "Kryerja e investimeve në fushën e infrastrukturës sportive".
2. Objekti i aktivitetit të shoqërisë behet si me poshtë:
 - I. Rindertimin, modernizimin dhe administrimin e stadiumit kombëtar Qemal Stafa me kusht ndalimin e ndryshimit të destinacioni;
 - II. Kryerja e investimeve në fushën e infrastrukturës sportive;
 - III. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër dhe plotësues dhe ndihmes që ka si qëllim ofrimin e cdo shërbimi tjetër dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor.
 - IV. Shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë të drejtperdrejtë ose të përbashkët në cdo shoqëri që ka objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e shoqërisë. Për këtë qëllim, shoqëria mund të bashkëpunojë me, ose në cdo mënyrë tjetër të drejtperdrejtë ose të përbashkët, të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose që kanë lidhje me objektin e shoqërisë ose ndihmes për realizimin e objektit të shoqërisë. Shoqëria për të garantuar detyrimet e veta dhe ato të paleve të treta mund të vendosë garanci, si peng ose barre hipotekore, përfshirë aktivitetin e saj. Në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet ekonomik, financiar, veprime me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, pjesërisht ose plotësisht, cdo tregti ose aktivitet tregtar dhe të zhvillojë cdo tregti ose aktivitet tjetër fitimprurës i cili mund të jetë dobiprurës në lidhje me aktivitetet tregtare të shoqërisë.
 - V. Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj ;
3. Zëvendësimin e z. Skender Hyka si anëtar i këshillit të administrimit për shkak se ka ndërruar jetë dhe emërimin e për një afat 3 (tre) vjeçar të anëtarit të këshillit të administrimit z. Arben Dervishaj;
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a

Tiranë, Rruga "Elbasanit",

NUIS: L 11705012 O

5. Autorizimin e z. Aldi Topçiu dhe z.Bledar Meneci që të dy së bashku ose veç e veç të ndjekin procedurat e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë.


Përfaqësuar nga

z. Armand DUKA



Përfaqësuar nga

z.Stefan KOÇOLLARI



VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A.

Në Tiranë, sot më datë 11 Janar 2021, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A., person juridik me NIPT L117050120, me seli në Sheshi "Italia", Stadiumi: "Air Albania", Tiranë .

Mbledhjen e drejton Z. Bardhyl Minxhozi Administrator i shoqërisë "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A., i cili konstaton se mbledhja është formalisht e vlefshme, pasi Asambleja e Përgjithshme është thirrur në përputhje me parashikimet e përcaktuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në RSH", të statutit të shoqërisë, si dhe, se janë prezentë si më poshtë :

1. Z. Armand Duka, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit "Federata Shqiptare e Futbollit", që zotëron 75 % të Shoqërisë.
2. Zj. Adriana Sheti, në cilësinë e përfaqësueses së aksionerit "Ministria e Financave", që zotëron 25 % të Shoqërisë.
3. Z. Bardhyl Minxhozi, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë.
4. Zj. Juliana Neziri, Specialiste e Shoqërisë dhe në cilësinë e mbajtjes së proces-verbalit të zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë.

REND DITE

1. Ndryshimin e selisë qendrore së shoqërisë QSKZ sha, në adresën e saj pranë Stadiumit Kombëtar të Tiranës, Sheshi Italia, Tiranë.
2. Zgjatjen e afatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit Z. Armand Duka dhe Z. Ilir Shulku për një afat tjetër 3 vjeçar që fillon nga data e mbarimit të mandatit të parë.
3. Zgjatjen e afatit të Z. Stefan Koçollari si anëtar të Këshillit të Administrimit për një afat tjetër 3 vjeçar që fillon nga data 12.01.2021.
4. Zëvendësimin e Anëtarit të Këshillit të Administrimit Z. Ramadan Shehi me Z. Aldi Topçiu, për një afat 3 vjeçar që fillon nga data e këtij vendimi.
5. Të ndryshme

Pas shqyrtimit të rendit të ditës asambleja e përgjithshme e aksionerëve,

VENDOSI :

- Të miratojë ndryshimin e selisë qendrore të shoqërisë "QSKZ" sh.a në adresën pranë Stadiumit Kombëtar të Tiranës, Sheshi Italia, Tiranë.
- Të miratojë zgjatjen e afatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit Z. Armand Duka dhe Z. Ilir Shulku, për një afat 3 vjeçar që fillon nga data e mbarimit të mandatit të parë.
- Të mos miratohet pika 3 e rendit të ditës. Z. Stefan Koçollari shkarkohet si anëtar i Këshillit të Administrimit dhe zëvendësohet me Znj. Gjinovefa Arizaj.
- Të miratohet zëvendësimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit Z. Ramadan Shehi me Z. Aldi Topçiu, për një afat 3 vjeçar që fillon nga data e këtij vendimi.
- Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të vërë në dispozicion të aksionerëve informacionin e kërkuar dhe të bëjë depozitimin e këtij vendimi në QKB.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE E SHOQËRISË

"QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A.

Për FSHF

Armand Duka

A handwritten signature in blue ink is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI SH.A." and "TIRANE - ALBANIA".

Për Ministrinë e Financave

Adriana Sheti

A handwritten signature in blue ink.

“QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI” sha
NIPT L117050120

Nr. 11 Prot

VENDIM I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI SHA

Në Tiranë, sot, në datë 20.01.2021, u mbledh Këshilli i Administrimit të Shoqërisë me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-------------------------|--|
| 1. Z. Armand Duka | Kryetar |
| 2. Z. Ilir Shulku | Anëtar (prezent me video call por jashtë territorit të Shqipërisë) |
| 3. Z. Arben Dervishaj | Anëtar |
| 4. Z. Aldi Topçiu | Anëtar |
| 5. Zj. Gjinovefa Arizaj | Anëtare |
| 6. Z. Bardhyl Minxhozi | Administrator ekzekutiv |

Me pjesëmarrjen e:

Zj. Juliana Neziri Sekretare

Rendi i Ditës:

- Diskutim mbi emërimin e administratorit të ri të QSKZ sh.a. Kejdi Tomorri.

Këshilli i Administrimit në këtë mbledhje me unanimitet votash:

VENDOSI:

1. Pranimin e dorëheqjes së Administratorit të shoqërisë QSKZ sh.a. z. Bardhyl Minxhozi.
2. Emërimin e Administratorit të ri të shoqërisë QSKZ sh.a. z.Kejdi Tomorri, për një afat 3 vjeçar, duke filluar nga data e këtij vendimi.
3. Një kopje e këtij vendimi do të depozitohet dhe në QKB për të pasqyruar ndryshimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkon drejtorinë dhe stafin ekzekutiv për zbatimin e tij.

Z. Armand Duka
Kryetar

Zj. Gjinovefa Arizaj
Anëtare

Këshilli i Administrimit

Z. Arben Dervishaj
Anëtar

Z. Bardhyl Minxhozi
Administrator Ekzekutiv

Z. Aldi Topçiu
Anëtar

Zj. Juliana Neziri
Sekretare

“QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI” sha
NIPT L117050120

Z. Ilir Shulku

Anëtar

Në mungesë fizikisht por prezent me video call në mbledhje

Z. Armand Duka kryetar

Zj. Juliana Neziri sekretare



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Z. Armand Duka'. To the right of the signature is a circular blue stamp. The stamp contains the text 'QENDRA SPORTIVE' at the top, 'KUQ E ZI' in the center, and 'SHA' below it. The outer ring of the stamp contains the text 'TIRANE - ALBANIA'.